

MUHARREM DEZHGIU

**ASPEKTE NGA VEPRIMTARIA POLITIKE E HYSNI TOSKËS
NË VITET 1912-1943**

Ngjarjet e mëdha dhe të vrullshme historike që kulmuan me themelimin e shtetit të pavarur shqiptar kanë ngërthyer mundin dhe përpjekjet e mijëra atdhetarëve shqiptarë. Jeta dhe vepra e tyre u bë mishi dhe gjaku i këtij shteti në të gjitha peripecitë dhe rrethanat, që iu deshën të kalonte më pas, për t'u forcuar dhe për të kryer funksionet e tij, si shtet kombëtar. Midis atyre atdhetarëve që vepruan vendosmërisht në mbrojtje të shtetit shqiptar, që në themelimin dhe tri dekada radhazi më pas, ishte dhe Hysni Shuaip Toska.

Edhe pse më tepër se tri dekada ka qenë pjesëmarrës aktiv në ngjarjet historike të kohës së tij, historiografia ende nuk e ka bërë vlerësimin e veprimtarisë së kësaj figure. Përkundrazi historiografia komuniste u përpoq për ta njollosur e denigruar figurën e tij. Ndaj, me anë të kësaj trajtесе të shkurtër, synojmë të hedhim dritë në veprimtarinë e këtij shqiptari atdhetar, në shërbim të vendit të tij, si shërbëstar i shtetit shqiptar.

*
* *
*

Deri në moshën 19-vjeçare Hysni Toska jetoi dhe punoi në fshatin e lindjes, në Luar, të rrethit të Fierit. Në këto vite kaloi një fëmijëri të vështirë prej jetimi. Në këtë moshë u rekrutua për kryerjen e shërbimit ushtarak në Janinë.

Gjatë kryerjes së shërbimit, Hysni Toska, bashkë me batalionin e tij në Kërçovë, tregoi aftësi dhe zotësi. Vitet e shërbimit ushtarak për llogari të Perandorisë Osmane i shërbyen për të fituar aftësi dhe përvojë lufte. Ai nuk harroi identitetin e tij si shqiptar në atë ushtri. Për aftësinë dhe zotësinë e treguar gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak u gradua shumë shpejt. Me fuqinë e tij ushtarake ai u dërgua nga një krahinë në tjetrën,

nga Kërçova në Follorinë, për të mbajtur qetësinë dhe rregullin kundër komitëve në ato treva.

Në vitin 1908, Namik Delvina, Bektash Cakrani dhe xhaxhai i Hysni Toskës, Asllan Toska, po bënë një mbledhje në Cakran për organizim lëvizjeje kundër osmanëve. Hysni Toska u shkoi në ndihmë me fuqinë e tij prej 40 vetësh. Veprimet e tij në Cakran kundër bimbashit Ismail Haki Libohova bënë të mundur që Bektash Cakrani me luftëtarët e tij të largoheshin nga rreziku i asgjësimit prej forcave të bimbashit¹.

Viti 1912 e gjeti Hysni Toskën të inkuadruar në radhët e komitëve që luftonin kundër pushtuesit osman. Me forcën e tij në Fier u bashkuan dhe Qani bej Dishnica, Izet Zavalani, Qemal Vrioni dhe të tjerë bashkëluftëtarë në lëvizjen e qëndresës kundër pushtuesit. Ndërkohë, ai ishte në qendër të vëmendjes së forcave qeveritare osmane, të cilat e ndiqnin kudo që shkonte. Madje, forcat ushtarake osmane i bastisën shtëpinë në Luar, duke e lënë të endej në Mallakastër. Komandanti i forcave ushtarake, Rruzhdin bej Idrizi, i kërkoi të atit të Hysniut, që t'i jepte informacion për vendndodhjen e djalit. Por, Shuaip Toska mbajti një qëndrim krenar për të birin, duke i lënë të kuptojë komandantit ushtarak se, djali vendos vetë. Dhe, më tej, ai shtonte se, sikur ai të donte të bëhej pashë “pse të mos e dua të bëhet Ali Pasha?”²

Qëndresa e shqiptarëve kundër Perandorisë Osmane tashmë në verë të vitit 1912, kishte kristalizuar kërkesat për njohjen e ekzistencës kombëtare të shqiptarëve, me po ato të drejta që gëzonin kombet e tjerë të Perandorisë.

Në esencë, shqiptarët i kishin unifikuar kërkesat e tyre dhe i kishin shpalosur nëpër kuvende, si në veri dhe në jug. I tillë ishte dhe Kuvendi i Sinjës, i mbledhur më 23 korrik 1912, i krerëve të Shqipërisë jugore, në promemorien e të cilit ndodhej dhe emri i Hysni Toskës³.

Veprimtaria atdhetare e Hysni Toskës spikati në mbështetje të Ismail Qemalit, për shpalljen e Pavarësisë. Në ato çaste historike ai dëshmoi vendosmërinë e tij në mbrojtje të shtetit të parë shqiptar të pavarur. Ai u tregua aktiv në kryerjen e detyrave të vështira në shërbim të

¹ Arkivi Qendror Shtetëror (më tej: AQSh), Fondi 32, Fondi: Lef Nosi, *Jeta e Hysni Toskës*, dos. 50, fl. 9-15.

² *Po aty*.

³ Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), A-232, nr.67, dos. 50. Promemorje mbi vendimet e marra nga Kuvendi i Përgjithshëm i Krerëve të Shqipërisë Jugore në majën e Malit Sinja, më 20-23 korrik 1912.

shtetit shqiptar, në mbrojtje të tij dhe për shtrirjen e sovranitetit të këtij shteti në trevat shqiptare.

Që nga Lushnja, Hysni Toska së bashku me nënprefektin Qazim Kokoshi dhe të tjerë atdhetarë, nënshkruan një telegram për Ismail beun në Vlorë, ku e përshëndesnin për aktin e ngritjes së flamurit. “Me plot gas - thuhej në telegram - marrim nderin t’u urojmë ditën e shenjtë që fatbardhësoi dhe shpëtoi Shqipërinë, për të cilën kombi u numëron shpëtimtar”⁴.

Në ditët e para të veprimtarisë së Qeverisë së Përkohshme, të formuar në Vlorë, Hysni Toska u vu në shërbim të qeverisë për stabilizimin e rendit e të qetësisë. Ai u ngarkua nga Ismail Qemali që me forcat e tij në batalionin e Fierit “me i shti në dorë dhe me i shtyp guximtarët që kanë kapur rrugën e banditizmit dhe dhunojnë njerëzit, për të kryer detyrën e për të siguruar me çdo mënyrë qetësinë e qarkullimin”⁵. Hysni Toska bëri përpjekje për të pajisur e furnizuar forcat e tij me armatim e veshmbathje⁶.

Në shërbim të qeverisë së Vlorës, me aksionet për ruajtjen e rendit në Mallakastër, u angazhuan edhe njerëz të afërt të Hysni Toskës. Një ndër ta ishte Hajredin Aga Hekali, djali i Musa Hekalit, vjehri i Hysniut⁷.

Në situatën komplekse të krijuar pas Shpalljes së Pavarësisë Hysni Toska u bë krahu i djathtë i Ismail Qemalit në mbrojtje të tokave shqiptare që kërcënoheshin nga pushtimi i fqinjëve. Me urdhër të Ismail Qemalit, ai vihet në krye të forcave shqiptare të qëndresës në Tepelenë, për të penguar forcat greke që synonin pushtimin e tokave shqiptare. Aleanca Ballkanike për luftë kundër Perandorisë Osmane përbënte një rrezik të drejtpërdrejt për trevat shqiptare, të cilat u bënë pjesë e pazarllëqeve të shteteve ballkanike, duke synuar ndarjen midis tyre.

⁴ *AQSh*, Fondi 145, viti 1912, D-II-1, fl. 68. Telegram nga Lushnja dërguar Ismail Qemal beut - Vlorë nga nënprefekti Qazim Kokoshi, Hysni Toska, Sulo Spathari etj. më 28.11.1912.

⁵ *Po aty*, D-II-36, fl.1. Telegram i Ismail Qemalit drejtuar Hysni Aga Toskës, 29 dhjetor 1912.

⁶ *Po aty*, Fondi 71, viti 1912, dos.1, dok. 8127. Telegram nga Fieri, drejtuar Qarkut të Elbasanit pranë kryesisë së Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, 3 dhjetor 1912 (dokumenti i përkthyer nga turqishtja).

⁷ *Po aty*, Fondi 71, viti 1912, dos.2, dok.11025. Telegrami i Kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës drejtuar prefektit të Beratit, 21 janar 1913.

Me porosi të Ismail Qemalit, Hysniu ngriti flamurin kombëtar në Tepelenë⁸. Pas këtij misioni historik ai kthehet në Vlorë, për të marrë detyrën tjetër nga Plaku i Vlorës, si komandant xhandarmërie. Ai do të nisej me urgjencë në zonën e Llogarasë, për t'i mbrojtur pozicionet nga forcat agresore greke, të cilat i kishte lëshuar Bektash Cakrani.

Me anë të pleqësisë së fshatit Dukat grumbulloi rreth 100 vullnetarë të armatosur, të cilët iu bashkuan forcës së tij prej 200 vetash. Me këto forca, Hysni Toska organizoi goditjen kundër forcave greke. Goditja e befasishme dhe përqendrimi i zjarrit në dy drejtime pati si rezultat paralizimin e trupave armike greke, të cilat u detyruan të iknin, të kapur nga paniku i thellë. Prapa tyre lanë gjithçka: çadra, pajime të ndryshme dhe ushqime. Në pikën kyçe të mbrojtjes së Llogarasë, Hysni Toska me forcat e tij kreu misionin në shërbim të shtetit shqiptar për afro 6 muaj, derisa u zëvendësua nga Alem Tragjasi nga Vlora⁹.

Më pas, Hysni Toska do të zhvendoste veprimtarinë e tij në prefekturën e Beratit, për ruajtjen e rendit dhe për të zgjidhur probleme shqetësuese për qeverinë e Vlorës. Ismail Qemali kishte besim në aftësitë e tij për të vendosur rregullin dhe drejtësinë, për të ngritur lart emrin dhe autoritetin e shtetit të ri shqiptar dhe të organizmave të tij. Zemërimi i Hysni Toskës shpalosej me ndëshkime të rrepta ndaj shkelësve të rendit dhe të rregullave që shteti kërkonte të zbatoheshin. Është vërtetë kuptimplot një episod i veprimtarisë së Hysni Toskës në këtë drejtim, të cilën na e përcjell bashkëkohësi i tij Lef Nosi, në shënimet e veta. Për një nga këto aksione të Hysniut ai tregonte: “Hysniu zuri ca hajdutë që kishin vjedhur, i leu me bojë, i nxorri në pazar dhe më pas i lëshoi, pasi ua paguan atyre që ua kishin marrë dhe pasi ua mori 200 napolonat qefil (garant) që të mos vidhnin ma. Me këto veprime që bëri Hysniu, vendi u qetësua”¹⁰.

I bindur se mbronte shtetin shqiptar, Hysniu u pozicionua drejt në zgjidhjen e konflikteve që lindën midis Ismail Qemalit dhe personave që iu kundërvunë atij, me qëllime ambicieje egoiste. Kështu, me ambicien për të bërë Cakranin, fshatin e lindjes, si qendër të nënprefekturës, Bektash Cakrani hyri në konflikt me Ismail Qemalin. Madje, Bektash

⁸ *Po aty*, Fondi 32, *bur. i përm.*, dok. 50, fl. 10.

⁹ *Po aty*, fl. 11.

¹⁰ *Po aty*, dos. 50, fl.11.

Cakrani kishte kërcënuar qeverinë e Vlorës me kryengritje¹¹. Konflikti i Bektash Cakranit me qeverinë e Ismail Qemalit kishte rrënjë edhe më të thella. Bektashi ishte kompromentuar për marrje të hollash nga Greqia, për ta zgjeruar kufirin e saj në dëm të tokës shqiptare¹², gjë të cilën e kundërshtonte Ismail Qemali. Bektash Cakrani u mor vesh edhe me Esat Toptanin, i cili i kishte premtuar t'i jepte një ndihmë prej 400 vetësh kundër qeverisë së Vlorës.

Si në rastet e tjera, qeveria e Vlorës, për të përballuar situatën, thirri forcën e Hysni Toskës. Ky i fundit, së bashku me Sali Vranishtin, drejtuan operacionin e goditjes kundër Bektash Cakranit, i cili kishte kaluar nga Luari, në Kuqan dhe më pas ishte hedhur në Margëlliç. Këtu, forcat e Hysni Toskës të ndara në 4 çeta me nga 50 vetë, ishin gati për goditjen shpartalluese kundër Bektashit. Fshatarët e detyruan Bektash Cakranin të largohej, sepse nuk donin që të bëheshin luftime. Ndërkaq, u kërkua nga Bektashi, të merrej vesh me Ismail Qemalin dhe t'i kërkonte falje. Atij iu propozua që të shkonte vetë në Vlorë, për të kërkuar falje para Ismail Qemalit, gjë të cilën Bektash Cakrani nuk e pranoi¹³.

Më pas, Bektashi iu drejtua Cakranit, ku u zhvillua konflikti i armatosur me forcat qeveritare. Forcat e tij u shpartalluan, kurse vetë Bektashi gjeti strehim në Imshtë, por i ndjekur nga forcat qeveritare, të drejtuar nga Hysni Toska. Në këto rrethana, B.Cakrani bashkohet me forcat e Esat Toptanit¹⁴.

Një tjetër kundërshtar i qeverisë së Vlorës ishte Dervish bej Biçaku, njëherazi dhe mik i Esat Toptanit. Në tetor të vitit 1913, ai ishte ngritur me një fuqi të armatosur kundër Aqif pashë Elbasanit, në atë kohë prefekt i qeverisë së Vlorës në Elbasan. Siç pohon Sejfi Vllamasi, Biçaku kishte dalë kundër qeverisë, duke bërë propagandë me kuran në dorë, për kryengritje. Ishte ky një qëndrim minues për Qeverinë e Vlorës, që kërkonte ndërhyrjen e fuqisë qeveritare të Hysni Toskës.

Hysni Toska bashkë me forcat e Aqif Pashës në Godolesh, e shpartalloi Dervishin (bej Biçakun -M.D.) aq keq, sa ky i fundit detyrohet të lerë në fushën e betejës kalin, dylbitë dhe kuranin”¹⁵.

¹¹ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, B-I-II, “Neraida”, Tiranë 2000, f.73.

¹² *Po aty*, f.73.

¹³ *AQSh*, Fondi 32, *bur. i përm.*, dos. 50, fl. 12.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ S. Vllamasi, *vep. e përm.*, f. 73-74.

Më vonë, në janar të vitit 1914, mësohet se Hysni Toska zuri Dervish beun (Biçakun - M.D.) në çiflik: “Besoj që është e vërtetë, - thoshte në një letër Çile Vreto - se elbasanasit, tani që është ushtria atje dhe që dëgjojmë mitrolozat, u bënë një me Aqif Pashën”¹⁶.

Hysni Toska qëndroi në Elbasan deri në ardhjen e princ V.Vidit. Është i njohur tashmë fakti se ardhja e princ Vidit në Shqipëri ishte një kundërvënie e idesë së ardhjes së një princi mysliman, qoftë edhe me origjinë shqiptare. Në këto rrethana, Austro-Hungaria përkrahu hapur Esat Pashë Toptanin, i cili nuk bashkëpunonte me qeverinë e Vlorës. Vendi ndodhej ndërmjet konvulsioneve të trazirave të brendshme, të pashmangshme për pushtet dhe ndërhyrjeve të fuqive të huaja për pushtim.

Në këto rrethana, Hysni Toska pozicionohet dukshëm kundër gjithë rreziqeve që i kërcënoheshin shtetit shqiptar. Atë e gjejmë në pozicionet e para të luftës kundër andartëve grekë, në zonën e Skraparit e të Përmetit. “E zuri luftën me grekun tek varret e Zavalanit, më tej Prishtes e për këtej Përmetit. Fuqia iu shtua me forcat që vinin nga Mallakastra dhe nga vendasit, gjer në 800 vetë”¹⁷.

Për jehonën e veprimeve të tij, në mbrojtje të trevave shqiptare, gazeta “Atdheu” e Shkodrës shprehej: “Për çështjen e Epirit, qeveria kishte vendosur të mblidheshin ushtarë e t’i çojnë në Epir, që t’i ndalojmë ligësitë që bëheshin nga grekët dhe të siguronin zonën e lirë... Është e vërtetë që nga këta që u mblodhnë, Hysni Toska vajti në Frashër dhe pas ca luftrash të rrepta që bëri, i mori viset e Frashërit”¹⁸.

Ndërkohë, vendi po rrezikohej nga forcat rebele të Haxhi Qamilit. Më 11 qershor 1914, Haziz Pashë Vrioni, me forcat e tij prej 700 vetësh, pasi ishte ndeshur dy herë me forcat rebele në Imshtë dhe në Kallm, kishte kapitulluar. Prandaj ai shpërmdau forcat dhe gjeti strehim në Fier. Hysni Toska mbajti qëndrim ndaj këtij veprimi kapitullues të Haziz Vrionit, duke e konsideruar tërheqjen nga luftimet kundrejt rebelëve një tradhti ndaj atdheut¹⁹.

¹⁶ *AQSh*, Fondi 22, viti 1914, dos.7, fl.69. Letër e Çile Vretos, dërguar Jani Vretos, ku e njofton për kapjen e Dervish bej Biçakut nga Hysni Toska, Vlorë, 22.1.1914.

¹⁷ *Po aty*, Fondi 32, *bur. i përm.*, dos.50, fl.13.

¹⁸ *Shkaqet si ra Berati*, gazeta “Atdheu”, Shkodër, 14 gusht 1914..

¹⁹ *AQSh*, Fondi 32, *bur. i përm.*, dos.50, fl.14.

Rebelët kryengritës kishin ndërmarrë një fushatë tmerruese mbi popullsinë e zonave ku kalonin. Motivet për këto veprime të tyre s'kishin të bënin aspak me ideale kombëtare. Veprimet e rebelëve u vlerësuan nga atdhetarët shqiptarë si rrezik serioz për vendin tonë.

Gazeta "Zëri i Shqipërisë" vinte në dukje se "Rebelët posa hynë në Lushnjë, zbritën flamurin shkabëtor dhe ngritën flamurin e Turqisë. Kur u siguruan se Myzeqeja mbeti në duart e tyre, sakaq nisën të ndjekin dhe të mundojnë shqiptarët atdhetarë... Mësuesit vojtnë shumë nga rebelët, u burgosën dhe u munduan si Krishti, duke dashur t'i frikësojnë që paskëtaj të mos guxojnë të thonë se janë shqiptarë. Dhe më tej, vazhdonte: "Lufta u nis me ata të paktë ushtarë që mbetnë dhe, sikur të mos ishte ndodhur trimi Hysni Toska, nga ana e Beratit, tërë këto ushtarë, me gjithë komandantin e tyre (Eshhtë fjala për komandantin e fuqive vullnetare të Mallakastrës Besim Koka -M.D.) do të ishin zënë robër nga ana e rebelëve"²⁰.

Studiues të njohur të këtyre ngjarjeve e kanë vlerësuar rolin e Hysni Toskës për kundërvënien që u bëri rebelëve. "E vetmja forcë reale në ndonjë krahinë si Mallakastra, e cila mundi t'i kundërvihet sadopak kryengritësve dhe të arrinte edhe t'i zbrapste ata përkohësisht në ndonjë pikë, qenë forcat e pronarëve të rinj të tokave si Hysni Toska, të cilët konsulli austro-hungarez në Vlorë, Majerhauzer, i cilësonte "agallarët e lidhur me tokën". Qëndrimi i tyre më i vendosur kundër kryengritësve, - vazhdon Gazmend Shpuza, - u përcaktua nga ajo që ata e panë qartë se çfarë rrezikshmërie paraqiste kryengritja fshatare jo vetëm për pronarët e mëdhenj çifligarë, por edhe për shtresën e tyre"²¹.

Motivimi i qëndrimit të vendosur të Hysni Toskës kundër kryengritësve të Haxhi Qamilit nisej në radhë të parë, nga rrezikshmëria e kryengritjes ose rebelimit për shtetin shqiptar të sapokrijuar. Nuk mund të përjashtohen dhe motivet e këtij qëndrimi të nisura nga interesa sociale. Në fund të fundit, mbrojtja e interesave të pronarëve të mëdhenj apo të rinj, ndikonte në mbrojtje të çështjes kombëtare shqiptare dhe të asaj elite që, tashmë, kishte mbështetur krijimin e shtetit shqiptar të pavarur. Asnjëherë një lëvizje e tillë rebele, siç ishte ajo e Haxhi Qamilit, me

²⁰ *Shkaku i prishjes së Myzeqesë*, Revista "Zëri i Shqipërisë", Shtëpia Botuese "Vitusha", Sofje, maj 1915. Drejtohej prej një komiteti me kryetar Th. Gërmenji dhe redaktor Kristo A. Dako.

²¹ Gazmend Shpuza, *Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme (1914-1915)*, Tiranë, 1986, f. 168.

motive e simbole antikombëtare, nuk mund të ishte një lëvizje progresive, përveç rastit, kur ajo lëvizje vlerësohet nga pozita klasore e tendencioze. Për qëndrimin e vendosur kundër rebelëve, Hysni Toska kërkoi të arrestohej²² ashtu siç ishin burgosur dhe të tjerë²³.

Trimëria dhe qëndrimi atdhetar i Hysni Toskës, duke luftuar kundër kryengritësve të Shqipërisë së Mesme, u pasqyrua dhe në gazetën “Dielli”, e cila e vlerësonte, duke e cilësuar “atdhetari i vërtetë dhe trimi me fletë, z. Hysni Toska”²⁴. Në Manastirin e Ardenicës, Hysni Toska luftoi trimërisht, duke lënë mjaft të vrarë nga radhët e rebelëve²⁵.

Hysni Toska bëri një fushatë mobilizuese në Dumre për të shtuar radhët e ushtrisë që komandonte ai. Kundërshtimin e forcave rebele e konsideronte si një domosdoshmëri që do të shpëtonte “atdheun që gjendej në rrezik”. Pikërisht, në ato çaste ndërhyri Bektash Cakrani, si armik vetiak i Hysniut, i cili me kërcënimet e tij e frikësoi popullin e Dumresë që të mos e pasonin Hysni Toskën. Ndërsa vetë u bashkua me rebelët dhe kështu Fieri ra në duart e tyre²⁶. Pas kësaj rebelët u drejtuan për në Berat. Hysni, i thirrur nga prefekti i Beratit, shkoi me të gjitha forcat. Ai luftoi mbi xhaminë e Murat Çelepies, duke i detyruar rebelët kryengritës të mos qëllonin ushtrinë e tij, por të tërhiqeshin, duke marrë malin²⁷. Megjithatë, Berati ra në duart e rebelëve, të cilët ekzekutuan tre atdhetarë: Baki Gjobrean, Hajredin Fratarin dhe Ismail Klosin.

Me luftimet që zhvilloi kundër rebelëve të Haxhi Qamilit, Hysni Toska tregoi jo vetëm cilësitë e një komandanti të aftë, por dhe cilësitë e një politikani largpamës. Objektivisht ai kishte kuptuar se zhvillimi e përparimi i Shqipërisë nuk mund të bëhej pa mbështetur qeverinë dhe shtetin shqiptar. Me veprimet kundër esadistëve dhe rebelëve tregonte se e kishte të qartë mendimin, sipas të cilit, veprimet dhe qëndrimet e rebelëve e minonin shtetin shqiptar.

Qëndrimi konsekuent i Hysni Toskës, për të shpalosur atdhedashurinë si dhe aftësinë e tij si luftëtar në shërbim të shtetit të pavarur shqiptar, tregonte dhe besimin e pakufishëm që kishte ai ndaj

²² AQSh, Fondi 886, dos. 652. Telegram i Nënprefektit të Tiranës, Abdullah, Fier, 21.1.1915.

²³ Po aty.

²⁴ Gazeta “Dielli”, Boston, 10 korrik 1914. Korrespondencë nga Fieri.

²⁵ S.Vilamasi, *vep. e për.*, f.102-103.

²⁶ Revista “Zëri i Shqipërisë”, Sofie, 6/19 maj 1915, f.22.

²⁷ AQSh, Fondi 32, *bur. i për.*, d.50, fl.14.

veprës së Ismail Qemalit. Ata kishin nevojë për njëri-tjetrin, në ato rrethana në të cilat gjendej Shqipëria. Ismail Qemali u jepte përgjigje bindëse dhe të zgjuar të gjithë skeptikëve që shprehnin dyshim për besimin që tregonte ai ndaj Hysni Toskës, duke i besuar që të komandonte forca të mëdha, pa qenë me shkollë ushtarake. “Neve jemi në fillim akoma - sqaronte Ismail Qemali. - Alem Tragjasin dhe Hysni Toskën m’i kërkon puna, prandaj i mbaj. Nëpunësat me diplomë le të emnohen atëherë kur të rregullohet Shqipëria”. Duke ju drejtuar sekretarit të tij, I.Qemali shtoi: “Të jeshë i sigurtë se për shumë kohë do të vazhdojë ky sistem këtu ke ne, me nëpunësa si Alemi, Hysni e shumë të tjerë”²⁸. Ende vendi kishte nevojë për njerëz e veprimtarë të tillë, që do të forconin shtetin, i cili do të krijonte mundësi për të bërë shtet me njerëz të shkolluar.

Në vitet e Luftës I Botërore, Shqipëria u bë shesh lufte midis fuqive ndërluftuese. Territori i saj u pushtua nga Austro-Hungaria, Serbia, Greqia, Italia dhe Franca. Ishte vënë në rrezik serioz ekzistenca e shtetit shqiptar të pavarur sikur ai të mos ekzistonte më parë. Hysni Toska dhe atdhetarë të tjerë kishin marrë pozicionim të hapur, si pro austro-hungarez. Madje, ai kishte marrë dhe një dekoratë trimërie nga princ Vidi²⁹.

Në fund të luftës ai u bë protagonist në zhvillimin e ngjarjeve historike të kohës. Me forcat civile që kishte grumbulluar, Hysni Toska dha ndihmesë për zhvillimin me sukses të Kongresit Kombëtar të Lushnjës. “Përgatitja që kishte ba Zogu për këtë kongres, ishte përfekte... Fuqitë vullnetare të Hysni Toskës, Veiz Sevranit, Alush Rrogzhinës ishin të gatshme të mbronin Kongresin”³⁰.

Vendimet historike të Kongresit, për sigurimin e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar, u jetësuan në Luftën e Vlorës. Hysni Toska ishte ndër veprimtarët më aktiv të kësaj lufte, duke treguar dhe aftësi drejtuese. Bashkëkohësit e krahasonin pamjen e tij të fuqishme me “trupin dhe fytyrën e një luani të zbutur përgjysmë”³¹. Hysni “kishte rënë shumë

²⁸ Bardhosh Gaçe, *Ata që shpallën pavarësinë kombëtare*, f. 278. “Çdo qeveri kishte nevojë për fuqinë e zotësinë e tij”.

²⁹ *Deputetët tanë. Z. Hysni Toska, deputet i Beratit*, revista “Minerva”, nr. 25, viti 1934.

³⁰ *Lëvizja Kombëtare kundër copëtimit të Shqipërisë*, në: gazetën “Atdheu”, maj 1993.

³¹ Ago Agai, *Lufta e Vlorës (Tregim i një pjesëmarrësi)*, Egjypt, 1960, f.192.

herë në përpjekje me armë e kishte dalë gjithnjë me nder. Fuqitë e Hysni Toskës u radhitën pranë topalltiasve të Vlorës që luftonin në Bestrovë e Panaja e gjer në det³². Me veprën luftarake në këtë ngjarje historike, ai hyri në këngën popullore të Mallakastrës. “Hysni Toska / Ja veshi si Siliqoka / T’u pritet armiqve koka/ Tradhtar mos ket më toka”.

Hysni Toska ishte një mbështetës i fuqishëm për Ahmet Zogun në gjendjen e krizës së thellë politike të vitit 1922. M. Kruja e njoftonte me shqetësim Bajram Currin, më 10 janar 1922, se kishte mbriritur në Hanin e Zallit, Ahmet Zogu me forcat e tij në drejtim të Tiranës. Në Tiranë ndodhej batalioni i Hysni Toskës, që thoshte se ishte besnik i qeverisë. Kjo e fundit mendonte t’i dërgonte këto forca kundër Ahmet Zogut, por më pas u tërhoq. Siç duket, Hysni Toska nuk ishte i disponueshëm të luftonte kundër Ahmet Zogut. Prandaj në krye të forcave qeveritare të asaj kohe u dërgua vetëm major Nazif Pogoni³³.

Në vitin 1924 për Shqipërinë u krijua një situatë tepër e rrezikshme. Etja karrieriste për pushtet bëri që, siç shprehej Dhimitër Berati “e mjera Shqipëri të gjendet në një tournant tepër të rrezikshëm”³⁴. Në këtë situatë, Hysni Toska u gjend në anën e qeverisë, për ta mbrojtur atë nga kryengritja e qershorit 1924. Pikërisht në situatën kur nga Veriu dhe nga Jugu, forca të prira nga ushtarakë të lartë ishin drejtuar kundër qeverisë së Tiranës, Hysni Toska mblodhi forca në Berat në mbështetje të qeverisë³⁵. Sipas vlerësimeve të kohës, dukej qartë se “këmbimi i Qeverisë nuk do ta ndalonte vëllavrasjen³⁶, sepse të dy grupimet - forcat qeveritare dhe forcat opozitare - kishin mbështetësit e tyre nga shtresa të caktuara të popullsisë shqiptare.

Pas rikthimit të qeverisë së Zogut, në fund të dhjetorit 1924 dhe pas shpalljes së Republikës shqiptare, në janar 1925, Hysni Toska mori pjesë aktive në jetën politike të vendit. Fillimisht ishte anëtar i Asamblesë Kushtetuese dhe, më pas, ishte deputet i qarkut të Beratit. Ai mori pjesë aktive në diskutimet parlamentare. Ai arsyetonte thjesht e kuptueshëm në parlament. “Po të sjellim grurë nga jashtë, thoshte Hysniu deputet, tre

³² *Po aty*, f.226; Maksim Zarka, *Histori dhe vlera*, tetor 2005, f. 139.

³³ *AQSh*, Fondi 418, viti 1922, dos.8/2, fl.363. Letër e Mustafa Krujës nga Tirana për Bajram Currin, 10.1.1922.

³⁴ *AQSh*. Telegram i Dhimitër Beratit për Mit’hat Frashërin, Tiranë, 31 maj 1924.

³⁵ *Po aty*.

³⁶ *Po aty*.

dëme na vijnë. *Një*, që dëmtohet bujku; *e dyta*, që nuk shiten të dhjetat me çmim të mirë dhe, *e treta*, se do të dalë para jashtë... Deri sa të dalë ky ligj është bërë gruri i vendit, se mundet që në Korçë bëhet në gusht, por në Berat arrin që në qershor. Të mos pranohet heqja e doganës për sjelljen e grurit³⁷. Sipas mendimit të tij, shitja e mishit jashtë vendit, do të stimulonte rritjen dhe shtimin e gjësë së gjallë, nga e cila, fshatarësia do të nxirrte fitime³⁸. Në mbledhjet e deputetëve Hysni Toska ishte aktiv në diskutimin e problemeve të karakterit të përgjithshëm legjislativ. Por, ai nuk harronte t'i sugjeronte rekomandime qeverisë, për të bërë kujdes në realizimin e detyrimeve të saj në interes të komunitetit që ai mbulonte si deputet, siç ishte problemi i rrugëve të Semanit apo rruga Mallakastër-Tepelenë³⁹.

Si deputet ai luajti një rol të rëndësishëm për vendosjen e qetësisë në rrethin e Fierit. Në gusht të vitit 1935, si nënkolonel rezervë, u mobilizua në shtypjen e lëvizjes së disa ushtarakëve që kishin për qëllim përmbysjen e monarkisë⁴⁰. Ndaj kryengritësve të Fierit u organizua një proces gjyqësor, i cili përfundoi me dënime të rënda për drejtuesit e kryengritjes.

Në vitin 1936, pas një kontributi të dukshëm në shërbim të shtetit shqiptar, Hysni Toska doli në pension. Edhe pas daljes në pension, jeta e Hysni Toskës ishte plot aktivitet e gjallëri në shërbim të njerëzve*.

Lajmin për rrezikun e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, më 1939, Hysni Toska e përjetoi në Berat. Si nënkolonel në pension, ai ndjente përgjegjësinë morale dhe atdhetare për të treguar aftësitë e tij si ushtarak me përvojë, në mbrojtje të vendit. Ai i bëri thirrje popullit të Beratit për organizim e mobilizim, për të mbrojtur vendin nga pushtimi italian. "Në moshën 65-vjeçare, Hysni Toska mblodhi forca nga Berati e

³⁷ *Po aty*, Fondi 146, viti 1928, dos.89, fl. 361. Procesverbali i diskutimeve në parlament, fl.20/30.

³⁸ *Po aty*, Fondi 146, viti 1926, dos. 100, fl. 307. Procesverbali i diskutimeve në parlament.

³⁹ Bisedimet e Dhomës së Deputetëve. Mbledhja XIII, viti 1926. Diskutim i z. H.Toska, f.332.

⁴⁰ *AQSh*, Fondi 252, viti 1935, dos. 33; Mentar Belegu, *Kryengritja antizogiste e Fierit*, Tiranë, 1987, f.104.

* Sipas bashkëkohësve, në shtëpinë e tij, Hysniu kishte mbledhur jetimët, të mbetur pa prindër. Ai u kujdes për ta si një prind i vërtetë, të cilët, jo vetëm i rriti me kujdes e ngrohtësi, por edhe i nxori në jetë.

Roskoveci dhe u nis drejt Vlorës”. I dëshpëruar nga ngjarjet që shënuan pushtimin e vendit, nuk u largua nga misioni, për ta çliruar atë, duke u pozicionuar hapur si antifashist i vendosur. Për veprimtarinë antifashiste shumë shpejt arrestohet nga italianët në Therepel të Skraparit. Emri i tij u shënuar në listën e të burgosurve nga italianët që më 1940⁴¹.

Rrugën e qëndresës kundër pushtuesit do ta ndiqte dhe i biri i Hysniut, Skënder Toska. Në gusht 1942, Komanda e Lartë e Karabinierisë njoftonte për arrestimin e Skënder Toskës, sepse “i ishte gjetur një letër ku shënoheshin 25 veta, të gatshëm për krijimin e një “republike” në Shqipëri”⁴². [kupto: për pavarësinë e Shqipërisë].

Pas një internimi në Ventotene të Italisë, Hysniu kthehet në shtëpinë e tij në vendlindje, i pritur ngrohtësisht prej bashkëqytetarëve të tij. Rruga e tij tashmë ishte përcaktuar si antifashist i vendosur. Ai pati raste të përcillte ngjarje të ndryshme luftarake, siç ishte konfrontimi luftarak midis forcave partizane dhe forcave të çetës kriminale të Isa Toskës.

Hysni Toskën nuk e lidhte asgjë me Isa Toskën. Përkundrazi, rruga e Hysni Toskës si antifashist i kundërvihet ashpër veprimtarisë spekulative e kriminale të Isa Toskës.

Më 12 mars të vitit 1943, Hysni Toska bashkë me atdhetarë të tjerë, i kërkuan qeverisë shqiptare me anë të një telegrami, që nga Berati, arrestimin e “kriminelit të bujshëm Isa Toska”⁴³. Midis të tjerash, aty thuhej se “me çetën e tij ka terrorizuar dhe ka masakruar për faqe të zezë të historisë dhe të traditave shqiptare, vëllezërit e tij të urtë e të bindur të krahinës Roskovec e gjetiu, për një kohë më shumë se dy vjet rresht, i kërkuar për ndëshkim nga autoritetet gjyqësore”. Më tej, - thuhej në telegram, - se “ai ishte një bishë e egër me fytyrë njeriu që s’ka lënë turp dhe njollë pa e ngarkuar në shpirtin e vet”⁴⁴. Në telegram jo vetëm dënoheshin veprimet dhe poshtërsitë e bëmave të Isa Toskës, por

⁴¹ *AQSh*, Fondi 149, viti 1940, dos.1139, fl.57. Në këtë listë emri i Hysni Toskës mban numrin 198.

⁴² *Po aty*, Fondi 1942, dos.1191/1, fl. 297. Shkresë e Komandës së Lartë Mbretërore të Shqipërisë dërguar Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Brendshme, 25 gusht 1942.

⁴³ *Po aty*, Fondi 153, viti 1943, dos.338, fl.6. Telegram i Hysni Toskës, Ali Çepele, Ramadan Volmishi, Kamber Kapo kundër Isa Toskës, 13.3.1943.

⁴⁴ *Po aty*.

shprehej dhe gatishmëria për t'u vënë në dispozicion të organeve të rendit, për të goditur me rreptësi e pa tolerancë "çetën" e Isa Toskës.

Duke qenë i pozicionuar qartë kundër veprimeve të Isa Toskës, Hysni Toska priste me padurim shkatërrimin dhe likuidimin e Isait që ishte bërë i neveritshëm për krahinat ku ai vepronte. Por, meqenëse kjo nuk ndodhi dhe Isai u bë i gjithëfuqishëm, Hysniu u largua nga fshati Luar dhe u vendos në një shtëpi në Berat, së bashku me fëmijët e tij.

Djali i vetëm i Hysni Toskës, Skënderi, bënte pjesë në formacionet e rinisë së Beratit dhe bashkëpunonte me Ajet Xhindolen. Shtëpia e Hysni Toskës u bë natyrshëm vendtakimi dhe i mbledhjeve të shokëve të Skënderit. Kështu, u forcuan lidhjet edhe me aktivisten tjetër të rinisë të Beratit, me Margarita Tutulanin. Miqësia dhe lidhjet midis tyre ishin në vazhdim të lidhjeve që kishin pasur prindërit e tyre, Milto Tutulani dhe Hysni Toska si deputetë, përfaqësues të prefekturës së Beratit në parlamentin shqiptar.

Me mendje e me shpirt ishte i vendosur për luftë kundër pushtuesit, për çlirimin e vendit. Mirëpo, mosha nuk i premtonte të merrte pjesë në formacione të organizuara nga forcat politike. Megjithatë, nëpërmjet djalit të tij, Skënderit, e jepte ndihmesën e tij për luftën çlirimtare.

Ishte shtator i vitit 1943, kur në udhëheqjen e PKSH kishte zënë vend bindja se kishte ardhur koha për të marrë pushtetin, pasi Italia kishte kapitulluar. Ardhja e gjermanëve në Shqipëri nuk ishte vlerësuar ende si rrezik serioz. Madje, në ndonjë krahinë si ajo e Beratit ishte arritur një kompromis i heshtur me ta⁴⁵. Vëmendja e forcave partizane ishte orientuar kundër forcave balliste të kësaj zone. Në këtë kategori kundërshtarësh politikë u vlerësua nga forcat partizane dhe Hysni Toska, ndërkohë që ai nuk kishte bërë pjesë asnjëherë në organizmat e Ballit Kombëtar.

Duke trilluar alibinë për të, si i afërm me Isa Toskën⁴⁶, Hysni Toska ishte vënë në shënjestrën e autoriteteve komuniste. Forcat nacionalçlirimtare të qarkut të Beratit, ku përfshiheshin dhe njësitet e batalionit "Shpiragu" e rrethuan më 15 shtator 1943, Hysni Toskën, në një lagje të Beratit. Atij iu kërkua të dorëzohej. Bashkë me të ishte e

⁴⁵ *Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm e të Komandës së Përgjithshme të UNÇSh*, vëll.I, botim i dytë, Tiranë, 1976, f. 144.

⁴⁶ Zyllyftar Veleshnja, *Kur ishim në luftë*, "Kujtime", Shtëpia botuese "Jonalda", 2001, f. 42. Sipas këtij autori "Hysni Toska ishte xhaxhai i Isa Toskës, i cili së bashku me të ungjin kishte vendosur të sulmonin çetën [partizane]" (!)

shoqja, e bija Erveheja dhe djali 17-vjeçar, Skënderi. Për këtë të fundit ishte i pakuptueshëm ky rrethim nga “shokët” e tij! Ndërkaq, luftimet e forcave partizane, me Hysni Toskën, vazhduan deri në orët e para të mëngjesit.

Për të mos rënë në duart e forcave partizane, dhe pasi iu mbaruan municionet, Hysni Toska vrau veten. Sipas dëshmimeve të të bijës së Hysniut, Ervehesë, vëllain e saj Skënderin e morën partizanët. Pas tre ditëve ai u gjet i vrarë afër Uznovës⁴⁷.

Në raportin e drejtuesve kryesorë të partisë së Brigadës VII, të Kadri Hoxhës, të Adil Çarçanit, të Ramiz Alisë dhe të Nijazi Demit, për Komitetin Qendror të PKSH, u denoncua Neshat Hysi si vrasës i Skënder Toskës. Në raport, për Neshatin, thuhej: “Është tip hakmarrës. Ka vrarë, p.sh. djalin e Hysni Toskës pa arsye dhe arbitrarisht ... Si kjo ka edhe shembëlla të tjera”⁴⁸.

Këtë veprim do ta dënonin të rinjtë e Beratit me një thirrje drejtuar popullit të Beratit, pas hyrjes së forcave nacionalçlirimtare (siç) në Berat. Duke iu drejtuar forcave nacionalçlirimtare, në thirrje pyetej në mënyrë kritike: “Ku e kini demokracinë e aq shumëtrumbetuar? Ku asht gjyqi i popullit që na lodhi veshët? Në vend të tyre na dhatë një terrorizim alla fashiste, me vrasje të pafajshmish si Kadri Qajajasi, Lalush Nallbani, Riza Nishica dhe Skënder Toska; mashtrime dhe shpifje bollëk dhe bllofe politike si ai i hyrjes së gjermanëve në qytet, për të rekrutuar rininë me anë të gënjeshtërisë e violencës brutale”⁴⁹.

Rrethimi i Hysni Toskës bashkë me pjesëtarët e familjes së tij, nga forcat partizane të Beratit, më 15 shtator 1943, përbënte një ngjarje, me të cilën Lëvizja Nacionalçlirimtare po zbatonte vendimet që mori pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes, për fillimin e luftës civile. Kjo rrethanë u shfrytëzua për të eliminuar mjaft nacionalistë.

Në rastin e goditjes së Hysni Toskës dhe të familjes së tij motivi politik nuk ishte argument justifikimi. Mbështetur në raportin e kuadrove të Brigadës VII⁵⁰ duket se elementë egoistë e karrieristë të lëvizjes

⁴⁷ Dëshmi e noterizuar e Ervehe Toskës. Ndodhet në arkivin e familjes.

⁴⁸ *AQSh/Arkivi i Partisë* (më tej: *AP*), Fondi 183, viti 1944, dos.11, fl.120. Letër e kuadrove të Brigadës VII për Komitetin Qendror të PKSH, 30 qershor 1944.

⁴⁹ *AQSh*, Fondi 270, viti 1943, dos.90. Thirrje drejtuar popullit të Beratit nga Namik Mehqemeja, Resul Tozhari, Fatbardh Guri, Hair Karkanjozi, tetuer 1943.

⁵⁰ *AQSh/AP*, Fondi 183, viti 1944, dos.11, fl. 120. Letër e kuadrove të Brigadës VII për Komitetin Qendror të PKSH, 30 qershor 1944.

nacionalçlirimtare në Berat, nuk mund të pranonin t'u bënte hije personaliteti i Hysni Toskës, me autoritet të padiskutueshëm në qarkun e Beratit. Prandaj, ata menduan se ai duhej eliminuar e zhdukur, që gjatë luftës. Pikërisht për këtë, u gjet momenti i përshtatshëm për ta asgjësuar, ai i fillimit të luftës civile. Më pas, rasti u trajtua si aspekt i zhvillimit të luftës klasore, për të zhdukur çdo gjurmë e dëshmi që kishte lidhje me veprimtarinë politike të Hysni Toskës.

Hysni Toska e kish filluar jetën e tij me armë në dorë dhe e përfundoi "po me armë në dorë e plot nder në një luftim, në të cilin, e bija e tij i mbushte armët e ai shtinte"⁵¹. Bashkëkohësit nuk ndjehen mirë kur kujtojnë mënyrën e vrasjes së patriotit dhe luftëtarit të madh Hysni Toska dhe djalit të tij, Skënder Toska⁵².

*
* *

Me veprimtarinë politike dhe ushtarake që shpalosi Hysni Toska gjatë jetës, gati gjysmëshekullore, për shtetin shqiptar, radhitet ndër ata figura historike që i bëjnë nder kombit tonë. Pjesëmarrja e tij në ngjarjet më kulmore historike shqiptare, gjatë gjysmës së parë të shek. XX, spikati përkushtim si atdhetar në shërbim të shtetit shqiptar. Ky qëndrim konstant si veprimtar politik e ushtarak përbën rezultanten historike të jetës së tij, që historiografia e ka për obligim ta trajtojë me realizëm e objektivitet shkencor.

S u m m a r y

ASPECTS FROM THE POLITICAL ACTIVITY OF HYSNI TOSKA (1912-1943)

This article aims to shed light on the activity of the patriot Hysni Toska in the service of the Albanian state for three decades as an active participant in the historical events of that period.

⁵¹ Ago Agaj, *Lufta e Vlorës* (Tregim i një pjesëmarrësi), Egjypt, 1960, f. 192.

⁵² Lllazar Bane, *Hysni Toska, krenari për kombin*, "Zëri i Popullit", 10 nëntor 2007.

It is evident his presence in many of events that preceded the act of the Declaration of Independence of Albania in 28 November of 1912. His activity later on was prominent in all directions of the organisation for the protection of the independent Albanian state leaded by Ismail bej Vlora.

Hysni Toska was positioned strongly against the rebel movement of peasantry lead by Haxhi Qamili during 1914-1915. The resistance against the rebellion was motivated by the danger that presented for the independent Albanian state.

By the end of WWI Hysni Toska gave his contribution for the successful development of the National Congress of Lushnje. He became a supporter of those forces of the time that aimed the stability of the Albanian state. As such he became an active member of the politics during the Albanian Republic (1925-1928) and of the Monarchy (1928-1939). With his political stand as a member of parliament in Albanian parliament and as a reservist officer he contributed for the stability of the Albanian state during the 20s and 30s of the 20th century.

Even though in retirement during the WWII Hysni Toska took a consequent stand as a patriot against the foreign invaders in Albania. His tragic end in September 1943 came as result of his strong resistance against the partisan forces in the area of Berat on the eve of civil war in Albania. Hysni Toska is one of the first victims of this political confrontation between Albanians.